

UDHËZUES PËR THIRRJEN NR. 4

Ky udhëzues ka për qëllim të japë instruksionet dhe informacionet e nevojshme për të gjithë të interesuarit për të aplikuar me koncept-ide në Thirrjen Nr. 4 të LevizAlbania. Udhëzuesi shpjegon hapat, procedurat, dokumentacionin e kërkuar, rregullat dhe afatet e të gjithë procesit të thirrjes, që nga hapja e saj, fazat pasardhëse dhe deri në përfundimin e procesit.

Ky udhëzues është veçanërisht i rëndësishëm për të gjitha ato Organizata Jo Fitimprurëse dhe individë që aplikojnë për herë të parë në thirrjet e LevizAlbania. Të gjithë janë të lutur që për çdo informacion apo paqartësi të na shkruajnë në info@levizalbania.al ose të kontaktojnë në numrin e telefonit +355 44 500 153.

RREGULLAT DHE PROÇESI

1. Kush mund të aplikojë:

Organizatat e Shoqërisë Civile (OJF), organizatat me bazë në komunitet, grupimet e të rinjve dhe grave, individët apo grupime të tyre, lëvizjet qytetare, organizatat e medias, gazetarë, institucione akademike, grupe të ndryshme interesi, janë të gjithë të ftuar dhe kanë mundësinë të aplikojnë në Thirrjen nr. 4 të LevizAlbania.

2. Afati dhe mënyra e dorëzimit të aplikimeve:

Thirrja është e hapur nga data 11 Shtator deri në datën 29 Shtator 2017, ora 17:00.


Në kuadër të forcimit të rolit të qytetarëve dhe krijimin e të gjitha lehtësirave për idetë që sjellin ndryshimin e nivelit të demokracisë vendore, në Thirrjen Nr. 4 LevizAlbania sjell për herë të parë formatin e aplikimit ONLINE. Mjafton të vizitoni faqen zyrtare www.levizalbania.al dhe të klikoni në rubrikën Thirrja për Aplikime Nr. 4, e cila ndodhet në mesin e faqes, lehtësisht e identifikueshme.

Formati i aplikimit online është i ndarë në dy kategori aplikimi, si OJF apo Individ, butona të cilët i gjeni në fund të tekstit të Thirrjes Nr. 4 të publikuar në këtë rubrikë.

Të rëndësishme për formatin e aplikimit online:

- Bëni kujdes në përzgjedhjen e një prej Drejttimeve të Thirrjes;
- Në përzgjedhjen e zonës së zbatimit, për më shumë se një (1) bashki duhet të mbani të shtypur në tastierën e kompjuterit butonin CTRL dhe më pas përmes MOUSE-it të përzgjidhni bashkitë e planifikuara. Në rast se idea juaj ka një shtrirje kombëtare, ky opsion ndodhet në krye të kategorisë “zona e zbatimit”. Në aplikimet përmes telefonit mobile mjafton të klikoni njëherë mbi çdo bashki për përzgjedhjen e shumëfishtë;

FINANCUAR NGA



ZBATUAR NGA



UDHËZUES PËR THIRRJEN NR. 4

- Në vendosjen e vlerës financiare të kërkuar për mbështetjen e idesë tuaj, në këtë fazë duhet të vendosni vetëm në vlerë numerike, shembull: 25500 (pa presje dhjetore, pa pika, pa viza në pjesën e poshtme të numrave apo në mesin e tyre);
- Respektoni limitin e karaktereve për secilën fushë që duhet të plotësoni. Limiti ndryshon për secilën prej fushave boshe sipas specifikimeve përkatëse dhe në rast të tejkalimit të tij sistemi nuk do t'ju lejojë të vijoni shkrimin;
- Aplikanti OJF, do të duhet të ngarkojë gjatë aplikimit vendimin më të fundit të gjykatës mbi organizatën, në formatin JPG (fotografi), në kategorinë që e kërkon këtë dokument;
- Aplikanti INDIVID, do të duhet të ngarkojë gjatë aplikimit një CV në formatin PDF ose Microsoft Word në kategorinë që e kërkon këtë dokument;
- **KUJDES:** Të gjitha fushat për tu plotësuar gjatë aplikimit janë të shenjua me shenjën * (asterix) dhe janë të detyrueshme për tu plotësuar, në rast të mos plotësimit të këtyre fushave nuk do të mundeni të përfundoni APLIKIMIN tuaj;
- Në përfundim majfton të klikoni “APLIKO” dhe keni përfunduar.

Në Thirrjen Nr. 4 të LevizAlbania mund të aplikohet edhe nëpërmjet dërgimit të aplikimit përmes postës zyrtare dhe formularin e koncept-idesë mund ta shkarkoni duke klikuar këtu: [**FORMATI I KONCEPT IDESË**](#), plotësojeni dhe dërgojeni atë me postë në adresën: **LevizAlbania, Rruga: Bardhok Biba, Pallati “Trema”, Hyrja “B”, Kati 9.**

KUJDES: Të gjithë aplikantët që do të përzgjedhin aplikimin përmes postës zyrtare do të duhet ta dërgojnë aplikimin dhe dokumentacionin e tyre të kopjuar në CD ose USB në të njëjtën dërgesë postare me aplikimin.

3. Drejtimet e Thirrjes


Vëmendje: Drejtimet e Thirrjes janë fusha në të cilën ju parashikoni të kryeni ndërhyrjen përmes idesë dhe aplikimit tuaj. Drejtimi i Thirrjes përcakton gjithashtu edhe limitin e grantit të kërkuar për një koncept-ide.

Drejtimi 1: Pjesëmarrja qytetare si një element i rëndësishëm në ndikimin e prioriteteve vendore

Temat kryesore që sugjerohen të mbulohen në konceptimin e idesë suaj dhe nevojës për ndërhyrje në Drejtimin 1, lidhen me pjesëmarrjen qytetare, por që nuk kufizohen me sa më poshtë, janë:

- Proçesi i planifikimit të investimeve;
- Përcaktimi i prioriteteve të buxhetit;
- Përmirësimi i shërbimeve dhe politikave vendore për grupe të veçanta;
- Përmirësimi i situatës apo politikave për prioritetet e komunitetit në sektorë si: mjedisi, infrastruktura, arsimiti, shëndetësia, etj.

FINANCUAR NGA

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

ZBATUAR NGA

 FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

 PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

 Co-PLAN

UDHËZUES PËR THIRRJEN NR. 4

Limiti i Granteve

- Për këtë drejtim limiti maksimal i grantit të kërkuar në koncept-ide është deri në 20,000 CHF për OJF dhe deri në 10,000 CHF për individë.
- Inkurajohen të aplikojnë OJF lokale dhe individë që planifikojnë ndërhyrjet në zonën e tyre të origjinës apo të banimit.

Drejtimi 2: Arti dhe inovacioni si mënyra alternative për të promovuar demokracinë vendore

Temat kryesore që sugjerohen të mbulohen në konceptimin e idesë suaj dhe nevojës për ndërhyrje në Drejtimin 2, por që nuk kufizohen me sa më poshtë, janë:

- Përdorimi i arteve vizuale dhe TIK për të përcjellë mesazhe për demokracinë apo për çështje të rëndësishme për një komunitet;
- Përdorimi i metodave inovative dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit për vizualizimin e funksioneve të pushtetit vendor dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.

Limiti i Granteve


- Për këtë drejtim limiti maksimal i grantit të kërkuar në koncept-ide është deri në 20,000 CHF për OJF dhe deri në 10,000 CHF për individë.
- Inkurajohen të aplikojnë të rinj të talentuar, individë dhe organizata aktive në fushën e Artit dhe Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit.

Drejtimi 3: Transparenca dhe llogaridhënia për institucione vendore të përgjegjshme ndaj qytetarëve

Temat kryesore që sugjerohen të mbulohen në konceptimin e idesë suaj dhe nevojës për ndërhyrje në Drejtimin 3, por që nuk kufizohen me sa më poshtë, janë:

- Monitorimi i shërbimeve të bashkive apo institucioneve të tjera të pushtetit qëndror që operojnë në nivel vendor;
- Gjenerimi i debatit publik për çështje të lëna mënjanë dhe/apo nuk kanë marrë vëmendjen e duhur nga qeverisja vendore nëpërmjet edhe bashkëpunimit me median;
- Realizimi i raporteve alternative për ushtrimin e kompetencave të bashkive për zbatimin në praktikë të ligjeve të rëndësishme për funksionimin e pushtetit vendor;
- Monitorimi i transparencës së institucioneve vendore (jo vetëm bashkive).

FINANCUAR NGA



ZBATUAR NGA



Limiti i Granteve

- Për këtë drejtim limiti maksimal i grantit të kërkuar në koncept-ide është deri në 50,000 CHF për OJF (që zbatojnë projekte jashtë zonës së origjinës) dhe deri në 10,000 CHF për individë.
- OJF-të që planifikojnë ndërhyrje jashtë zonës së origjinës së tyre, do të duhet të mbulojnë të paktën 3 bashki, duke pasur partneritet me një OJF lokale në secilën zonë ku do të ndërhyhet.
- Aplikantët të cilët kualifikohen pas konkursit të ideve, duhet të përcaktojnë qartë në buxhet shpërndarjen e fondeve për aktivitetet e organizatave partnere në zonat e ndërhyrjes.

4. Kriteret e Vlerësimit


Kriteret kryesore për vlerësimin e koncept-ideve janë si më poshtë:

- Përputhja e koncept-idesë me drejtimet e thirrjes;
- Përshkrimi i qartë i problemit, qëllimit dhe objektivave specifikë;
- Metodologjia dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë (nëse planifikohen);
- Vazhdimësia/qëndrueshmëria e projektit;
- Kapaciteti zbatues/menaxhues i individit (vetëm për aplikantët individë).

5. Rregulla të Përgjithshme për Aplikimin dhe Informacion Shtesë

- OJF-të duhet të dërgojnë vendimin më të fundit të Gjykatës së Rrethit Tiranë;
- Individët duhet të dërgojnë CV e tyre (vetëm CV e individit aplikant në PDF);
- Një individ mund të aplikojë në emër të një grupi qytetarësh aktivë në komunitet pavarësisht nëse ky grup është regjistruar ose jo në gjykatë;
- Nuk pranohen aplikime që vijnë nga organizata apo individë që kanë një kontratë granti në zbatim të financuar nga LevizAlbania;
- Në Thirrjen për Aplikime lejohet aplikimi i OJF-ve apo individëve vetëm një herë;
- LevizAlbania nuk njuh si shpenzim Tatimin për Vlerën e Shtuar (TVSH);
- Kostot administrative të lejuara (përfshirë edhe pagat e stafit) nuk duhet të tejkalojnë 20% të totalit të buxhetit të propozuar;
- Afati maksimal i zbatimit të projekteve është deri në 15 muaj.

FINANCUAR NGA



ZBATUAR NGA



UDHËZUES PËR THIRRJEN NR. 4

LevizAlbania NUK inkurajon projekte/aktivitete që synojnë:

- Ofrimin e shërbimeve sociale;
- Realizimin e kompetencave/detyrave të pushtetit vendor;
- Trajnime të administratës vendore;
- Projekte që planifikojnë vetëm dhe kryesisht zhvillimin e tryezave të rrumbullakëta/seminareve që nuk sjellin rezultat konkret e të prekshëm për qytetarët;
- Printime të fletëpalosjeve, broshurave, posterave & publikimeve nuk janë të preferuara, por inkurajohet përdorimi sa më shumë i medias sociale dhe teknologjive inovative dhe alternative;
- Koncept-ide që vijnë nga shoqatat e njësive vendore.

6. Hapat e Thirrjes për Drejtimet 1, 2 dhe 3:

Mekanizmi i përzgjedhjes së projekteve/granteve më të mira për Drejtimet 1, 2 dhe 3 të Thirrjes për Aplikime Nr. 4 të LevizAlbania kalon në tre faza që sigurojnë transparencë, përfshirjen e grupeve të interesit dhe cilësinë sa më të lartë të aplikimeve në përputhje me drejtimet e thirrjes.

• **Informimi dhe Aplikimi**


Gjatë periudhës që Thirrja Nr. 4 do të qëndrojë e hapur LevizAlbania do të organizojë 4 sesione informuese, në të cilat janë të ftuara të gjitha organizatat e shoqërisë civile, individët dhe grupimet e tyre dhe të gjitha kategoritë e lartpërmendura në fillim të udhëzuesit, dhe ku do të diskutohet mbi drejtimet dhe procedurat e thirrjes dhe do t'i jepet përgjigje të gjitha pyetjeve që të interesuarit do të shfaqin në raport me Thirrjen për Aplikime. Takimet do të zhvillohen si më poshtë:

- 13 Shtator – ora 10.00 në Qytetin e Vlorës, pranë Qendrës Rinore
- 15 Shtator – ora 10.00 në Qytetin e Shkodrës, pranë “Hotel Grand”
- 18 Shtator – ora 10.00 në qytetin e Korçës, pranë Qendrës Rinore
- 21 Shtator – ora 11.00 LIVE në Facebook në faqen e projektit @LevizAlbania

• **Konkurset e Ideve**

Idetë (aplikimet) më cilësore do të përzgjidhen dhe do të ftohen të prezantohen nga vetë aplikantët gjatë “Konkursit të Ideve”. Konkursët e Ideve do të zhvillohen në tre rajone që do të përcaktohen nga LevizAlbania. Bordi i Granteve i përbërë nga përfaqësues dhe ekspertë të njohur të shoqërisë civile, qeverisjes vendore dhe medias nga Shqipëria dhe nga rajoni (Kosovë dhe/ose Maqedoni) do të përzgjedhë idetë më cilësore që do të kalojnë në fazën e tretë. Konkursët e Ideve janë të hapura për të gjithë aplikantët dhe transmetohen drejtpërdrejt në median sociale të LevizAlbania.

FINANCUAR NGA



ZBATUAR NGA



UDHËZUES PËR THIRRJEN NR. 4

- **Përgatitja e Projekt-Propozimeve të Plota**

Gjatë kësaj faze aplikantët (OJF apo individë) e përzgjedhur, do të përgatisin projektin e plotë, duke reflektuar plotësisht sugjerimet dhe komentet e bëra nga Bordi i Granteve, i cili do të marrë dhe vendimin përfundimtar për to.

7. E Drejta e Ankimimit


Aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së një kërkesë-ankese, e cila duhet të bëhet jo më vonë se shtatë ditë kalendrike nga data e dërgimit të informacionit nëpërmjet njoftimit me shkrim nga LevizAlbania apo botimit të listës së koncept-ideve të përzgjedhura në faqen zyrtare të LevizAlbania (gjatë Konkursit të Ideve njoftimi bëhet drejtpërdrejt) dhe duhet të përshkruajë qartë bazën e problemit/ankimimit. Ankimimi duhet të bëhet direkt nga aplikanti dhe jo nga përfaqësues ose ndërmjetës ligjorë të tij. Kërkesë-ankesa duhet të bëhet me shkrim nga ankimuesi. Përgjigja e plotë i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 15 ditë nga afati i përcaktuar për të bërë ankimimin. Në përgjigjen e parë, ankimuesi informohet se kur do të marrë një përgjigje përfundimtare nga LevizAlbania.

8. Fondet indikative për çdo drejtim

Çfarë janë fondet indikative? LevizAlbania, në kuadër të transparencës informon aplikantët dhe të gjithë të interesuarit se fondet në dispozicion për secilin nga drejtimet e Thirrjes për Aplikime, janë si më poshtë:

Drejtimet e Thirrjes Nr. 4	Limiti maksimal i grantit	Shuma në total për çdo drejtim
1. Pjesëmarrja qytetare si një element i rëndësishëm në ndikimin e prioritetëve vendore.	Maksimumi OJF: 20,000 CHF Maksimumi individë: 10,000 CHF	300,000 CHF
2. Arti dhe inovacioni si mënyra alternative për të promovuar demokracinë vendore.	Maksimumi OJF: 20,000 CHF Maksimumi individë: 10,000 CHF	150,000 CHF
3. Transparenca dhe llogaridhënia për institucione vendore të përgjegjshme ndaj qytetarëve.	Maksimumi OJF: 50,000 CHF Maksimumi individë: 10,000 CHF	250,000 CHF

FINANCUAR NGA



ZBATUAR NGA

